



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/GJYKATA KOMERCIALE
SUDSKI SAVET KOSOVA/ PRIVREDNI SUD - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL/COMMERCIAL COURT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 7 paragrafit 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 23 paragrafi 2 dhe 3 dhe neni 24 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, neni 30 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës të Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 8 shtator 2022,

Miraton:

RREGULLORE NR. 09/2022
PËR REKRUTIMIN DHE EMËRIMIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË
GJYKATËN KOMERCIALE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton procesin e rekrutimit dhe emërimit të këshilltarit ligjor në Gjykatën Komerciale.
2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen ndaj të gjithë kandidatëve për këshilltar ligjor gjatë procesit të rekrutimit dhe emërimit, kryetarit të gjykatës, anëtarëve të komisioneve të përcaktuara me këtë rregullore, si dhe ndaj të gjithë zyrtarëve të tjerë të cilët janë të përfshirë në këtë proces.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin:

- 1.1. **Ligji** – Ligji për Gjykatën Komerciale;
- 1.2. **Gjykata Komerciale** - siç parashihet në Ligjin për Gjykatën Komerciale;
- 1.3. **Kryetari** – Kryetarin e Gjykatës Komerciale, ashtu siç parashihet në Ligjin për Gjykatën Komerciale;
- 1.4. **Këshilltar Ligjor** - zyrtari me kompetencë i cili menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të Njesisë Ligjore në mënyrë autonome, nën mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës;
- 1.5. **Komisioni për Rekrutim** - Komisionin e themeluar nga Kryetari i Gjykatës Komerciale, përgjegjës për zhvillimin e procedurave për rekrutimin, përzgjedhjen preliminare dhe vlerësimin e kandidatëve për Këshilltar Ligjor;
- 1.6. **Komisioni për Rishqyrtim** - Komisionin e themeluar nga Kryetari i Gjykatës Komerciale, përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve në procesin e rekrutimit për Këshilltar ligjor;
- 1.7. **Anëtar i Komisionit** - anëtarin e emëruar nga Kryetari i Gjykatës Komerciale, i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin për Gjykatën Komerciale dhe këtë rregullore;
- 1.8. **Anëtar rezervë i Komisionit** - anëtarin e emëruar nga Kryetari i Gjykatës Komerciale, i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit apo rasteve të tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar;
- 1.9. **Rezultati përfundimtar i procesit të rekrutimit** - rezultatin e përgjithshëm që fitohet nga shumica e pikëve të grumbulluara të rezultateve nga intervista.

Neni 3 Parimet

Procesi i rekrutimit dhe emërimit të këshilltarit ligjor duhet të jetë i hapur, transparent dhe me mundësi të barabarta të ofrimit të kushteve për të gjithë kandidatët.

Neni 4 Këshilltari Ligjor dhe përgjegjësitë e tij

1. Këshilltari ligjor është pozitë e nivelit drejtues dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e Njesisë Ligjore në mënyrë autonome, nën mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës, siç shprehimisht përcaktohet me dispozitën e nenit 24 të Ligjit për Gjykatën Komerciale dhe aktet tjera të miratuara nga Këshilli.

2. Këshilltari ligjor së paku një herë në muaj, raporton para kryetarit për punën e tij. Kryetari mund të kërkoj edhe raportime të veçanta. Këshilltari ligjor dorëzon raportin me shkrim tek kryetari i gjykatës.

3. Në mungesë të këshilltarit ligjor, kryetari në koordinim me administratorin e gjykatës përkatëse, cakton një zëvendësues për të ushtruar përkohësisht detyrën, deri në emërimin e këshilltarit ligjor, ashtu siç parashihet me ligj dhe me këtë rregullore.

KAPITULLI II KOMISIONET

Neni 5

Komisioni për Rekrutim

1. Kryetari i Gjykatës Komerciale themelon Komisionin për Rekrutim të këshilltarit ligjor në Gjykatën Komerciale.
2. Komisioni për rekrutim ka mandat vetëm për një konkurs dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë, nga të cilët një (1) gjyqtar i dhomave të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, dy (2) gjyqtarë të dhomave të shkallës së parë dhe një anëtarë rezervë i cili vjen nga dhomat e shkallës së parë.
3. Komisioni për Rekrutim interviston kandidatët për këshilltar ligjor nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional të Gjykatës Komerciale, kandidatë për pozitën e këshilltarit ligjor.
4. Anëtarët e Komisionit për Rekrutim pas vlerësimit të koncept dokumentit të prezantuar nga kandidati dhe rezultatin nga intervista me gojë, paraqesin rekomandimet e tyre me shkrim për secilin kandidat të suksesshëm, i cili i dorëzohet kryetarit.

Neni 6

Komisioni për Rishqyrtim

1. Kryetari, themelon Komisionin për Rishqyrtim lidhur me procesin e rekrutimit për pozitën e këshilltarit ligjor në Gjykatën Komerciale.
2. Komisioni, përbëhet prej tre (3) anëtarëve, prej të cilëve dy (2) gjyqtarë nga dhomat e shkallës së dytë, një (1) gjyqtar nga dhomat e shkallës së parë, dhe një anëtarë rezervë i cili vjen nga dhomat e shkallës së dytë.
3. Komisioni për Rishqyrtim është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve lidhur me procesin e rekrutimit të këshilltarit ligjor, duke siguruar që procesi ka qenë i hapur, transparent, dhe me mundësi të barabarta të ofrimit të kushteve për të gjithë kandidatët.

Neni 7

Konflikti i interesit

Subjektet bartëse të procesit të rekrutimit të këshilltarit ligjor duhet të bëjnë përpjekje që të parandalojnë dhe/ose t'i shmangen çfarëdo situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

KAPITULLI III

KUSHTET E PËRGJITHSHME, SHPREHJA E INTERSIT PËR APLIKIM DHE PROCESI I REKRUTIMIT

Neni 8

Kushtet e përgjithshme

Të drejtë aplikimi për pozitën e këshilltarit ligjor kanë vetëm bashkëpunëtorët profesional të cilët punojnë në Gjykatën Komerçiale.

Neni 9

Shprehja e Interesit për aplikim

1. Gjykata Komerçiale shpall njoftim të brendshme për shprehje të interesit për aplikim për pozitën e këshilltarit ligjor.

2. Njoftimi përmban informatat si në vijim:

- 1.1. përshkrimin e detyrave të punës;
- 1.2. mënyrën e dorëzimit të dokumenteve;
- 1.3. afatin për shprehje të interesit.

Neni 10

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Kandidati duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- 1.1. kërkesën për shprehjen e interesit për pozitën e këshilltarit ligjor;
- 1.2. koncept dokumentin që paraqet visionin e tij/saj lidhur me udhëheqjen dhe mbikqyrjen e Njesisë Ligjore, CV-në dhe dokumentet tjera mbështetëse.

2. Kërkesa së bashku me dokumentet mbështetëse dorëzohen në gjykatë në kopje fizike apo përmes postës elektronike, e cila regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e kërkesës.

3. Për secilin kandidat krijohet dosje që përmban të gjitha dokumentet e prezantuara nga kandidati, për të cilën përgjegjës është Komisioni për Rekrutim.

Neni 11

Procesi i vlerësimit

1. Procesi i vlerësimit të kandidatit përfshinë koncept dokumentin dhe intervisten me gojë.

2. Koncept dokumenti do të vlerësohet deri në pesëdhjetë 50 pikë si dhe intervista me gojë deri në pesëdhjetë 50 pikë.

3. Intervista me gojë do të përmbajë gjithsejt pesë (5) pyetje: tri (3) pyetje nga aspekti menaxherial, një (1) pyetje rreth motivimit dhe një (1) nga etika profesionale, ku secila nga pyetjet do të vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë.

3.1. Kandidati vlerësohet nga komisioni menjëherë pas përfundimit të intervistës.

Neni 12 Njoftimi për intervistë

1. Pas kalimit të afatit për shprehje të interesimit për pozitën e këshilltarit ligjor dhe vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidat, Komisioni për Rekrutim fton kandidatin për intervistim së paku shtatë (7) ditë para mbajtjes së intervistës.

2. Diten e mbajtjes së intervistës, Komisioni për Rekrutim përpilon listën me pyetje për kandidatët sipas fushave të përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregullore, të cilat do të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët.

Neni 13 Njoftimi i kandidatëve

1. Pas përfundimit të procesit vlerësues dhe intervistues, Komisioni për Rekrutim njofton kandidatët për rezultatet e arritura.

2. Njoftimi për rezultatin e arritur përmban emrin, mbiemrin dhe rezultatin e arritur për secilin kandidat sipas pikëve.

Neni 14 E drejta në ankesë

1. Kandidati i pakënaqur, ka të drejtë ankesë për të kundërshtuar procesin e rekrutimit dhe rezultatin e arritur, në afat prej pesë (5) ditëve, nga dita e njoftimit të bërë sipas kësaj rregullore.

2. Ankesa e kandidatit nga paragrafi 1 i këtij neni, shqyrtohet nga Komisioni për Rishqyrtim, në afat prej tri (3) ditëve, nga dita e përfundimit të afatit të ankesës.

3. Në rast se Komisioni për Rishqyrtim, pas vlerësimit të ankesës, gjen se janë bërë shkelje të rregullave rreth përmbajtjes dhe organizimit të intervistës me gojë siç është përcaktuar me këtë rregullore, mund të marrë vendim që të përsëritet intervista me gojë për kandidatin, ankesa e të cilit është aprovuar.

4. Nëse, Komisioni për Rishqyrtim, vendosë që të përsëritet pjesa përkatëse e intervistës, intervista organizohet brenda pesë (5) ditëve, nga vendimi i Komisionit për Rishqyrtim. Me këtë rast Komisioni për Rekrutim do të hartojë pyetje të reja, rezultatet e të cilave do të merren parasysh me rastin e përpilimit të listës përfundimtare të procesit të rekrutimit.

Neni 15
Raporti final i procesit të rekrutimit dhe vendimi për emërim

1. Anëtarët e Komisionit për Rekrutim pas përfundimit të procesit të rekrutimit përpilojnë raportin me shkrim me anë të të cilit përshkruhet ecuria e gjithë procesit të rekrutimit dhe rekomandimet për kandidatët e propozuar për emërim, të cilin i'a dorëzojnë Kryetarit.
2. Kryetari i Gjykatës pas shqyrtimit të raportit me rekomandimet e pranuar nga anëtarët e Komisionit për Rekrutim, emëron njërin nga kandidatët e propozuar.
3. Kryetari i'a dorëzon Këshillit raportin e Komisionit për Rekrutim dhe vendimin për emërim të këshilltarit ligjor. Një kopje e vendimit dhe dosjës së kandidatëve ruhet në Gjykatën Komerciale.

Neni 16
Ruajtja e dosjës së kandidatit

Ruajtja e dosjës së kandidatit bëhet në bazë të rregullave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare. Të dhënat janë konfidenciale dhe çasja në dokumentet e ruajtuara bëhet në pajtim me dispozitat në fuqi.

Neni 17
Shtojcat e rregullores

1. Shtojcat që i janë bashkangjitur kësaj rregullore janë pjesë përbërëse të saj:
 - 1.1. Shtojca 1: Aplikacioni për pozitën e këshilltarit ligjor;
 - 1.2. Shtojca 2: Formular i vlerësimit nga anëtari i komisionit në intervistën me gojë për pozitën e këshilltarit ligjor;
 - 1.3. Shtojca 3: Formular i vlerësimit nga anëtarët e komisionit në intervistën me gojë për pozitën e këshilltarit ligjor;
 - 1.4. Shtojca 4: Formular për vlerësimin përfundimtar nga komisioni për pozitën e këshilltarit ligjor.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.


Albert Zogaj,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
Datë: 13.09.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/GJYKATA KOMERCIALE
SUDSKI SAVET KOSOVA/ PRIVREDNI SUD - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL/COMMERCIAL COURT

FORMULAR PËR SHPREHJE TE INTERESIT/ OBRAZAC ZA ISKAZIVANJE INTERESA

INSTITUCIONI/ INSTITUCIJA: _____

Titulli i pozitës/ Naziv radnog mesta: _____

Numri i referencës së pozitës/ Broj reference radnog mesta: _____

Ju lutemi përgjigjuni në çdo pyetje qartë dhe plotsisht dhe plotësoni me ngjyrë të kaltër ose të zezë. Aplikacioni duhet të nënshkruhet/ Molimo vas da na svako pitanje odgovorite potpuno. Pisite citko plavim ili crnim mastilom. Aplikacija mora biti potpisana.

Emri - Ime				Mbiemri - Prezime				
Data e lindjes/ Datum rođenja/				Gjinia/ Pol/	M/M	F/ZH	<input type="checkbox"/>	
Vendi dhe komuna e lindjes-Mesto rođena i opština/								
Nr. personal i letërnjoftimit - Licni broj licne karte:								
Gjendja martesore Bracno stanje	I/e pa martuar Neozenjen	I/e martuar Ozenjen	<input type="checkbox"/>	I/e shkurorëzuar Razveden	<input type="checkbox"/>	I/e ve Udovac/a	<input type="checkbox"/>	
Adresa e tanishme/ Adresa stanovanja/								
Adresa e përhershme, nëse ndryshon nga e tanishmja / Stalna adresa ako nije ista sa sadasnjom/								
Numri i telefonit / Broj telefona:		Tel:		E-mail:				
A dëshironi të deklaroheni për përkatësinë etnike, nëse përgjigja është "PO", shënoni cila është përkatësia juaj./ Da li hocete da se izjasnite o etnickoj pripadnosti, ako odgovor je "DA", recite koja je vasa etnicka pripadnost:					PO - DA	JO-NE	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
SHKOLLIMI: Jepni detaje të plota, titujt e saktë të gradave shkencore/								
OBRAZOVANJE: Dajte potpune podatke, navedite tacan naziv diplome/								
Universiteti/ Univerziteti:								
Emri dhe vendi i Institucionit Ime i lokacija Institucije	Vijimi - Pohadjane			Titujt, nderimet akademike/ Diplome, akedems ko priznanje	Drejtimi i studimeve/ Predmet studija			
	Prej-Od	Deri-Do						
Shkolla e mesme ose shkollim tjetër i mesëm - Srednja skola ili drugo srednje obrazovanje								
Emri dhe vendi i Institucionit Ime i lokacija Institucije	Vijimi - Pohadjane			Çertifikata ose diploma e fituar Dobijeni certikati ili diplome				
	Prej-Od	Deri-Do						

ostale profesionalne kvalifikacije/

Emri dhe vendi i Institucionit Ime i lokacija Institucije	Lloji - Vrsta	Prej-Od	Deri-Do	Çe. ose diploma e fituar/ Dob.Cert. ili diplome

Përvoja e punës (duke filluar nga ajo e fundit), të jepen detaje të plota dhe të qarta./

Radno iskustvo (poceti sa naj skorijim), iznesite potpune i jasne podatke./

Titulli i vendit të punës/ Naziv radnog mesta/		Prej-Od	Deri-Do	Emri i mbikëqyrësit/Ime nadzornika
Emri i punëdhënësit/ Ime poslodavca/				
Adresa e punëdhënësit/ Adresa poslodavca/				
Numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje/ Broj i vrsta personala pod nadzorom/				
Arsyet e largimit nga vendi i punës/ Razlog za napustanje radnog mesta/				

Përshkrimi i detyrave të punës/Opis radnih zadataka/

Titulli i vendit të punës/ Naziv radnog mesta/		Prej-Od	Deri-Do	Emri i mbikëqyrësit/Ime nadzornika
Emri i punëdhënësit/ Ime poslodavca/				
Adresa e punëdhënësit/ Adresa poslodavca/				
Numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje/ Broj i vrsta personala pod nadzorom/				
Arsyet e largimit nga vendi i punës/ Razlog za napustanje radnog mesta/				

Përshkrimi i detyrave të punës/Opis radnih zadataka/

Naziv radnog mesta/								
Prej-Od			Deri-Do			Emri i mbikëqyrësit/Ime nadzornika		
Emri i punëdhënësit/ Ime poslodavca/								
Adresa e punëdhënësit/ Adresa poslodavca/								
Numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje/ Broj i vrsta personala pod nadzorom/								
Arsyet e largimit nga vendi i punës/ Razlog za napustanje radnog mesta/								
Përshkrimi i detyrave të punës/Opis radnih zadataka/								
Përdor letër tjetër nëse ke nevojë lidhur me përvojën e punës/ Ako je potrebno upotrebite dodatne papire oko radno iskustvo/								
A keni qenë ndonjëherë të dënuar më tepër se gjashtë muaj/Da li ste bili osudjivani vise od šest meseci/					PO-DA: <input type="checkbox"/>		JO-NE:	
Njohja e gjuhëve: Cila është gjuha juaj amtare/ Znanje jezika: Koji je vas maternji jezik/						Gjuha Shqipe		
Gjuhët tjera/ Drugi jezici	Leximi-Citate		Shkrim-Pisete		Në të folur-Pricate		Kuptoj-Razumete	
	Mirë/ Dobro/	Jo mirë/ Tesko	Mirë/ Dobro/	Jo mirë/ Tesko	Mirë/ Dobro/	Jo mirë/ Tesko	Mirë/ Dobro/	Jo mirë/ Tesko
Gjuha Angleze	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Aftësitë me kompjuter - Rad na racunaru								
ëord		Excel		Database		Programe tjera - Drugi progr.		
Themelore/ Osnovno/	Mirë/ Dobro/	Themelore/ Osnovno/	Mirë/ Dobro/	Themelore/ Osnovno/	Mirë/ Dobro/			
<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>				
Shënoni detajet e aftësive tjera të cilat i keni dhe mund të shërbejnë për postin e aplikuar. Navedite podaci drugim vestinama a koje mogu biti potrebno za trazeno radno mesto.								
Shënoni arsyet për aplikimin në pozitën përkatëse, pritjet nga vendi i punës dhe qëllimet e karrierës/ Navedite razlog za odredjenju poziciju, ocekivanja od radnog mesta i ciljevi karijere/								

afërm apo mbikëqyrës nga puna juaj e kaluar.

PREPORUKE: Na vedite dhe osobe, skojima niste u srodsvu niti predpostavleni, koje su u poznate sa vasim karakteristikama i kvalifikacijama.

Emri i plotë - Puno ime	Adresa	Profesioni - Zanimanje

Shënim: Kandidatët duhet të sigurojnë fotokopjet dokumenteve sipas njoftimit të shpallur për shpreje të interesit dhe të sjellin origjinalet e tyre për verifikim me rastin e intervistës/

Zapis: Kandidati trebaju podoneti fotokopiju trazenih dokumenata na osnovu obaveštenja o iskazivanju interesovanja, te sobom poneti originale dokumenta za verifikaciju prilikom intervjuisnja:

1. Dëshmi të kualifikimeve shkollore - Dokaz o obrazovnim kvalifikacijama

2. Dëshmi për përvojën e punës - Dokaz o radnom iskustvu

3. Letër rekomandimet - Preporuke

4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlersimit të punës/
Kopije iz dva zadija izvestaja za procenu rada/

5. Dokument identifikimi - Dokument identifikacije

VËREJTJE:

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

OPOMENA:

Ako uz prijavu niste priložili potrebna dokumenta i niste popunili tačne podatke, izgubićete priliku da budete u užoj listi.

Garantoj se kam dhënë informacione të vërteta, korrekte dhe complete në këtë formular/
Potvrđujem da sam dao/dala istinite, tačne i potpune informacije/

Nënshkrimi/Potpis: _____ Data/Datum: ____/____/____

Kërkesa e kompletuar duhet të mbyllet në kuvertë dhe të dërgohet në adresën sipas njoftimit të brendshëm për shprehje të interesit.



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ GJYKATA KOMERCIALE

SUDSKI SAVET KOSOVA/ PRIVREDNI SUD - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL/COMMERCIAL COURT

FORMULAR I VLERËSIMIT NGA ANËTARI I KOMISIONIT NË INTERVISTËN ME GOJË PËR POZITËN
E KËSHILLTARIT LIGJOR/
OBRAZAC ZA OCENU ČLANA KOMISIJE U USMENOM RAZGOVORU ZA POZICIJU PRAVNOG SAVETNIKA

Emri i kandidatit: _____

Datë: _____

Ime kandidata: _____

Datum: _____

Lëmia / oblast	Numri i pyetjeve për lëmi Broj pitanja za oblast	Pikët maksimale/ maksimalni bodov	Pikët e fituara Osvojeni bodovi	Vlerësimi nga anëtarit i Komisionit ¹ / Ocenjivanje od člana komisije	Komente (nëse ka) Komentar (ako ima) <i>Udhëzohet sidomos për kandidatët me vlerësim min. dhe max./ preporučuje se posebno za kandidate sa min. i max. ocenom</i>
Integriteti personal dhe profesional i kandidatit Liçni i profesionalni integritet kandidata	1	10			
Njohuri të përgjithshme menaxheriale, komunikuese dhe në vendimmarrje Opšte upravljačko, komunikativno i znanje u donošenju odluka	3	30			
Motivim	1	10			
Pikët e fituara në intervistë/ Osvojeni bodovi u intervju					

Nënshkrimi i anëtarit të komisionit/vlerësuesi/ _____

Potpis člana komisije/ocenjivač _____

¹ Dispozita e nenit 11, par.3 përcakton se Intervista me gojë do të përmbajë gjithsejt pesë (5) pyetje: tri (3) pyetje nga aspekti menaxherial, një (1) pyetje rreth motivimit dhe një (1) nga etika profesionale, ku secila nga pyetjet do të vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë.

¹ Odredbom člana 11, stav 3. utvrđuje da usmeni intervju da sadrži ukupno pet (5) pitanja: ti (3) pitanja iz rukovodećeg aspekta, jedno (1) u vezi sa motivacijom i jedno (1) iz profesionalne etika, gde će se svako pitanje oceniti sa deset (10) bodova.



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ GJYKATA KOMERCIALE

SUDSKI SAVET KOSOVA/ PRIVREDNI SUD - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL/COMMERCIAL COURT

**FORMULAR I VLERËSIMIT NGA ANËTARËT E KOMISIONIT NË INTERVISTËN ME GOJË PËR
POZITËN E KËSHILLTARIT LIGJOR/**

**OBRAZAC ZA OCENU ÇLANOVI KOMISIJE U USMENOM RAZGOVORU ZA MJESTO PRAVNOG
SAVJETNIKA**

Emri i kandidatit: _____

Datë: _____

Ime kandidata

Datum

Pikët maksimale në intervistë me gojë / Maksimalni broj poena na usmenom intervjuu	Vlerësimi Individual / Individualno ocenjivanje			Rezultati përfundimtar / Konaçni rezultat ¹
	Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivanje člana	Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivanje člana	Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivanje člana	
100				

Komisioni për Rekrutim/ Komisija za prijem	Emri dhe mbiemri / Ime i prezime	Nënshkrimi / Potpis
Anëtar i Komisionit / Çlan Komisije		
Anëtar i Komisionit / Çlan Komisije		
Anëtar i Komisionit / Çlan Komisije		

¹ Rezultati përfundimtar i intervistës me gojë për një kandidat fitohet duke nxjerr mesataren e pikëve të fituara nga secili anëtar i komisionit. Ndërsa, mesatarja nxirret duke mbledhur vlerësimin e të tre anëtarëve të Komisionit Rekrutues/vlerësues, shumë e së cilës e pjesëtojmë me 3 (që është numri i anëtarëve të komisionit.)

¹Konaçan rezultat usmenog intervjuja za kandidata dobija se oduzimanjem proseka bodova koje je ostvario svaki član komisije. Dok se prosek dobija sabiranjem ocene tri članova /ocenjivača a Komisije za regrutaciju, čiji iznos delimo sa 3 (što je broj članova komisije)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/GJYKATA KOMERCIALE
DSKI SAVET KOSOVA/ PRIVREDNI SUD - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL/COMMERCIAL COURT

KOMISIONI PËR REKRUTIM / KOMISJA ZA PRIJEM

FORMULAR PËR VLERËSIMIN PËRFUNDIMTAR NGA KOMISIONI PËR POZITËN E
KËSHILLTARIT LIGJOR /
OBRAZAC ZA KONAÇNU OCENU KOMISIJE ZA POZICIJU PRAVNOG SAVETNIKA

Emri i kandidatit: _____
Ime kandidata: _____

Data : _____
Datum: _____

Pjesa e provimit Deo Ispita	Pikët Maximale/ Maksimalni bodovi	Vlerësimi i Komisionit ¹ / Ocenjivanje komisije	Pragu i kalueshmërisë / Prag prolaznosti
Koncept dokumenti	50		
Intervista me gojë / Usmeni intervju	50		
<u>Rezultati përfundimtar i provimit / Konaçni rezultat ispita</u>			

Komisioni për Rekrutim / Komisija za prijem	Emri dhe mbiemri / Ime i prezime	Nënshkrimi / Potpis
Anëtar i Komisionit / Član Komisije		
Anëtar i Komisionit / Član Komisije		
Anëtar i Komisionit / Član Komisije		

¹ Dispozita e nenit 11, par.2 përcakton se koncept dokumenti do të vlerësohet deri në pesëdhjetë 50 pikë si dhe intervista me gojë deri në pesëdhjetë 50 pike.

¹ Odredbom člana 11. stav 2. Utvrđuje da će se koncept dokument occiti do pedeset 50. bodova, kao i usmeni intervju do pedeset bodoa.